

URDHËR
Nr. 680, datë 21.12.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 615, DATË 9.11.2020 “PËR
MBYLLJEN E BAREVE, RESTORANTEVE, *FAST FOOD* DHE LOKALEVE”
TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të nenit 7, pika 4, germa “b”, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, si dhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 5005/8, datë 21.12.2020, me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar COVID-19 në Republikën e Shqipërisë dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 615, datë 9.11.2020, “Për mbylljen e bareve, restoranteve, *fast food* dhe lokaleve”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Pika 1 e urdhrit rifomulohet si vijon:

“Kufizimin e aktivitetit të bareve, restoranteve, *fast food*, lokaleve që ofrojnë shërbim për klientët në të gjithë vendin, nga ora 20:30 deri në orën 06:00 duke filluar nga datë 24.12.2020 deri në datën 4.1.2021.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe fillon efektet më datë 24.12.2020. Pas datës 4.1.2021 kufizimi i aktivitetit të bareve, restoranteve, *fast food*, lokaleve, që ofrojnë shërbim për klientët në të gjithë vendin do të jetë në fashën orare nga ora 22:00 deri në orën 06:00 deri në një urdhër të dytë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu